



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.3433/8 prot.

Datë 26.12.2024

**V E N D I M**

**Nr.1860/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Tërnova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.12.2024 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-26387-10-25-2024, me objekt “Smart Parking ne Kalane e Beratit”, me fond limit 5,265,500.00 (pesë milion e dyqind e gjashtedhjet e pesë mijë e pesëqind) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

“TETRA” shpk me NUIS K72017027P, me adresë: Rruga Gjin Bue Shpata ,Pallati 2/1, Ap.2,Njesia Bashkiake Nr.5.

“QuantX IT Solutions” shpk me NUIS M31904013D, me adresë: Rruga e Dibres,Njesia administrative Nr.8, kati I Pare.

**Subjekte të interesuar:**

Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK, me NUIS J61820057C, me adresë: Rruga Sali Butka, Pallati Pajtoni, Shk.2, Kati 7, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Berat, me adresë: BULEVARDI REPUBLIKA, Berat.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulet monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë ankimuar në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “TETRA” shpk nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimesi “QuantX IT Solutions” shpk, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.10.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-26387-10-25-2024, me objekt: “SMART PARKING NE KALANE E BERATIT”, me fond limit 5,265,500.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.11.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

II.2. Në datën 11.11.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 11.11.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

<i>“INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” SHPK</i>	<i>4.500.000,00 lekë Kualifikuar</i>
<i>“QuantX IT Solutions” SHPK</i>	<i>4.728.000,00 lekë Kualifikuar</i>
<i>“TETRA” SHPK</i>	<i>4.965.000,00 lekë Kualifikuar</i>
<i>“TCN” SHPK</i>	<i>4.756.146,00 lekë Skualifikuar</i>

II.4. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4820, datë 21.11.2024 dhe me nr. 3433/2024 prot., datë 21.11.2024 i operatorit ekonomik “TETRA” SHPK, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK dhe “QuantX IT Solutions” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3433/2 prot, datë 25.11.2024, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tetra” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.4.2 Me anë të shkresës nr. 6513/2 prot., datë 02.12.2024, me objekt “Kthim pergjigje ankeses nr.prot 3433/2024”,protokolluar prane Komisionit te Prokutimit Publik me nr.3433/5 prot., datë 04.12.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Tetra” shpk, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës si më poshtë vijon:

[...]

*“Nga verifikimi i kryer nga Komisioni Shqyrtimit të Ankesave, rezulton se publikimi i njoftimit të fituesit paraprak në sistemin e prokurimi elektronik nga Autoriteti Kontraktor është bërë në datën 26.11.2024, dhe nga kjo datë i lind e drejta për ankimim operatorëve ekonomik ofertues sipas legjislacionit ne fuqi. Sa më sipër operatori ekonomik ankimues “TETRA” Shpk nuk ka respektuar afatet ligjore për ankesën e paraqitur në datën 21.11.2024 dhe si e tille nuk pranohet.*

#### **IV. Konkluzioni:**

***Sa me sipër komisioni vendos:***

1. *Mos pranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” shpk me NUIS K72017027P Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata ,Pallati 2/1, Ap.2,Njesia Bashkiake Nr.5.”*

II.5. Në datën 02.12.2024 njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4850 dhe me nr. 3529/2024 protokollu, datë 02.12.2024, e operatorit ekonomik

“QuantX IT Solutions” SHPK, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.1 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3529/2 prot, datë 03.12.2024, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5.2 Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nga operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK në Sistemin e Ankesave Elektronike janë paraqitur argumente ne date 03.12.2024, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, argumenta të cilat janë protokolluar me tonën me nr. 3529/3 prot., datë 04.12.2024.

II.5.3 Me anë të shkresës nr. 6652/2 prot., datë 10.12.2024, me objekt “Kthim pergjigje ankeses nr.prot 3529/2024”, protokolluar prane Komisionit te Prokutimit Publik me nr.3529/6 prot., datë 10.12.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” shpk, referuar shkresës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës si më poshtë vijon:

[...]

#### **IV. Konkluzioni:**

##### ***Sa me sipër komisioni vendos:***

1. *Mos pranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, me NUIS 2 M31904013D Adresa: Rruga e Dibres , Njesia administrative Nr 8 Tirane, Vila nr.153, Kati i Pare zona kadastrale nr 8360 1001.*

II.6. Me shkresën nr. 3529/7 prot, datë 17.12.2024, është përcjellë tek autoriteti kontraktor kërkesa për informacion nga Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me dorezimin e te gjithë dokumentacionit te paraqitur ng operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.

II.7. Në datën 20.12.2024 është depozituar nga autoriteti kontraktor shkresa nr. 7074/1 prot., protokolluar me tonën me nr. 3529/8 prot, datë 23.12.2024, në të cilën konstatohet dokumentacioni i kërkuar lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. A/2024/4820, datë 21.11.2024 dhe me nr. 3433/2024 prot., datë 21.11.2024 i operatorit ekonomik “TETRA” SHPK, ne lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK dhe “QuantX IT Solutions” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 30.10.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-26387-10-25-2024, me objekt: “SMART PARKING NE KALANE E BERATIT”, me fond limit 5,265,500.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.11.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

III.1.2. Në datën 11.11.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Në datën 25.11.2024, nga autoriteti kontraktor është bërë publikimi i njoftimit të fituesit paraprak.

III.1.4 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se në datën 21.11.2024, datë në të cilën operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar njoftimin e fituesit, e as njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

III.1.5. Neni 111, pika 1, e Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: “1. “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”

III.1.6. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e

lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”

III.1.7. Në nenin 97, pikat 2, “Afatet për paraqitjen e ankesave” të VKM-se nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Tetra” SHPK, ka paraqitur në datën 21.11.2024, nëpërmjet sistemit të aplikimit të ankesave online, ankesën pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me nr. 3433/2024, datë 21.11.2024. Ndërkohë nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor në këtë datë, pra 21.11.2024, nuk është publikuar as njoftim - fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datën 21.11.2024 (data që

operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën), nuk ishte publikuar as njoftim fituesi e as njoftimi i anulimit të procedurës.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, më datë 21.11.2024, afati i paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, nuk kishte filluar ende, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, apo njoftimi i anulimit të procedurës, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 21.11.2024, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar racione temporis.

III.1.9. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “TETRA” shpk, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK tij me arsyen se: *“Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.1, të kritereve të veçanta për kualifikim, shtojca 8 e DT, Këtë pretendim i referohemi informacioneve të bEra publike në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Agjencia e Prokurimit Publik, si dhe Open Spending Albania [https://spending.data.al/sq/treasury/list/faqe/2/year/2019/perf\\_id/INFORMATIONBUSINESSSYSTE MS-IBS](https://spending.data.al/sq/treasury/list/faqe/2/year/2019/perf_id/INFORMATIONBUSINESSSYSTE MS-IBS), verehet se nuk ka realizuar furnizime të ngjashme . Ne, kemi dyshime të arsyeshme që OE i ka paraqitur faturat e eksperiencës në ente publike të pashoqëruara me vërtetimin përkatës.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).*



*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
- *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK, në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Fatura tatimore shitje si më poshtë:

FATURA TATIMORE SHITJE			
Numri i faturës	Data	Vlera pa tvsh lekë	
1.	43/2022	13.06.2023	xxx
2.	46/2022	21/06/2022	xxx
3.	117/2022	21/10/2022	xxx
4.	170/2022	30/12/2022	xxx

- *Vërtetim realizim kontrate nr.222 prot., datë 26.01.2023, lëshuar nga autoritetit kontraktor Autoriteti Portual Durres për Kontratë nr.3419 prot., datë 30.12.2022 lidhur ndërmjet Autoriteti Portual Durres dhe operatorit ekonomik INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK me vlerë xxx lekë pa tvsh me objekt ”Materiale informatike”.*

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.2.6. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni,

*vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

III.2.7. Në nenin 40 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

III.2.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të

kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.2.9. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së mëparshme të ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të lotit apo grupeve të loteve në rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik ankimes, porë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mallrat objekt prokurimi dhe sasi të respektive të tyre. KPP gjykon se, në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me blerjen e pajisjeve për kontroll të parkimeve. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar është parashikuar se: *“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”*. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërkimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është

rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme.

Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

III.2.10.Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK se nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 8 e DT, (*“Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.”*). Konkretisht të gjitha faturat e ngjashme të paraqitura nga “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK për qëllime kualifikimi janë dorëzuar me vërtetimin nr.222 prot., datë 26.01.2023, lëshuar nga autoritetit kontraktor Autoriteti Portual Durres për Kontratë nr.3419 prot., datë 30.12.2022, dhe me për më tej janë kontrata të fushës së pajisjeve elektronike (Switch, printer, çeles, pjese kembimi per barrier krah ngritese, etj), të cilat qartësisht janë të ngjashme me objektin e prokurimit qëndron pasi Autoriteti Kontraktorë në kriterin nr. 2.3.1 ka përcaktuar kontrata të ngjashme dhe jo kontrata të së njëjtës natyrë gjë e cila me kontratat e paraqitura nga ana e “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK e bën të përmbushur në mënyrë të plotë kriterin e lartpërmendur, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK, konstaton se në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2. të këtij vendimi.

Lidhur me faktin nëse kontratat e ngjashme dhe faturat tatimore të shitjes të paraqitura nga operatori ekonomik e “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK, i plotësojnë apo jo kriteret kualifikues të furnizimeve të ngjashme, KPP do t’i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë, komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar. Për sa i përket vlefshmërisë së kontratave dhe faturave të dorëzuara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kontratat dhe faturat e paraqitura janë të vlefshme për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi, pra janë realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës (30.10.2024). Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes, dhe kontratave të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik e “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të shitjes, dhe kontratave të dorëzuara nuk dëshmon, se ka kryer furnizime të natyrës së mallrave objekt prokurimi, sikurse janë blerja e pajisjeve për kontrolle në parkime. KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre faturave dhe kontratave, rezulton se këto (faturat dhe kontratat) konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, kontratat e paraqitura janë të natyrës “Materiale informatike” (Switch, printer, çeles, pjese kembimi për barrier krah ngritese, etj), pra operatori ekonomik ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit. Lidhur me komponentin e tretë, për sa i përket vlerës së faturave dhe kontratave të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se vlera e realizuar është ajo që kërkohet në kriterin kualifikues. Sa më sipër KPP vlerëson se, faturat tatimore të shitjes, nga operatori ekonomik ankimues “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK plotësojnë të tre komponentët kumulative në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim se bashku me vertetim nr.222 prot., datë 26.01.2023, lëshuar nga autoritetit kontraktor Autoriteti Portual Durres për Kontratë nr.3419 prot., datë 30.12.2022, për përvojë të suksesshme të ngjashme përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK tij me arsyen se: *“Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 8 e DT, Duke qene se OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS , nga eksperiencia nuk ka instaluar sisteme parkimi si dhe referuar website <https://www.ibs.al/#projects> nuk ka partneritet me asnje nga brandet e*

*parkimi, kemi dyshime se Certifikata e paraqitura JANE TE Brandit CAME dhe saktesisht CAME PARKARE PKE , nuk jane te specifikuar modeli i pajisjes qe i referohet certifikimi CE, nderkohe dhe dokumenti i paraqitur jane ne gjuhen TE HUAJ dhe jo tE shoqeruara me nje pErkthim tE noterizuar nE gjuhEn shqipe sipas percaktimeve ne Dokumentat e Tenderit.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.1** *“Operatori ekonomik duhet te paraqes certifikate CE për mallrat pjese e procedurës se prokurimit ne veçanti për :*

- 1) Pajisje per leshimin dhe matjen e kohes e parkimit, me ekran dhe aksesore;*
- 2) Pajisje per kontrollin e pageses se parkimit me display dhe aksesore;*
- 3) Pajisje bariere per kontrollin e levizjes se mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit);”*

III.3.2. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin*

*e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.3.3. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.3.4. Në nenin 40 pika 4 dhe 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“3. “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*



*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

III.3.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikues dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.3.6. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me mallrat pjese e procedurës së prokurimit ka

kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin certifikate CE ne veçanti për :

- 1) Pajisje per leshimin dhe matjen e kohes e parkimit, me ekran dhe aksesore;
- 2) Pajisje per kontrollin e pageses se parkimit me display dhe aksesore;
- 3) Pajisje bariere per kontrollin e levizjes se mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit).

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit per mallra te sigurt te standarteve specifike europiane dhe së dyti, nese kjo kërkesë në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur kete synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa e mësipërme i shërben synimit të autoritetit kontraktor pasi është e nevojshme për realizimin e synimit te sigurise, për artikujt 1) Pajisje per leshimin dhe matjen e kohes e parkimit, me ekran dhe aksesore; 2) Pajisje per kontrollin e pageses se parkimit me display dhe aksesore; 3) Pajisje bariere per kontrollin e levizjes se mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit)”. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit plotesimin e nje kriteti te tille, dhe me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK gjenden qartazi “*Deklaratat e Konformitetit te BE-se*” me modelet perkatese dhe te perkthyer nga perkthyesja e licensuar Z. Mimoza Backa, sipas vertetimi te perkthimit Nr Rep 6623, date 07.11.2024. KPP-ja gjykon se është realizuar kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor per sigurin e mallrave te kerkuara specifikisht me standaret europine nga operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK tij me arsyen se: “*Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.2, të kritereve të veçanta për kualifikim, shtojca 8 e DT, e, kemi dyshime tE arsyeshme qE OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS, nuk ka paraqitur Autorizim prodhuesi ose Distributori te autorizuar te rregullt pEr zErat : ? Pajisje per leshimin dhe matjen e kohes e parkimit, me ekran dhe aksesore; CAME ? Pajisje per kontrollin e pageses se parkimit me display dhe aksesore CAME ? Pajisje bariere per kontrollin e levizjes se mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit) CAME Autorizimi i leshuar nga CAME per 3(tre) zerat) e mesiperm nuk eshte i rregullt sepse nuk ploteson kerkesat: ? duhet te lEshohet ne emEr te autoriteti kontraktor ? te pErmbajE te dhEna te plota si e-mail, numEr kontakti, adrese, faqe web te prodhuesit, kjo ne rast verifikimi nga autoriteti kontraktor. Nderkohe OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS ska paraqitur Autorizim prodhuesi ose Distributori te autorizuar per zerin: ? Software qendror per menaxhimin e qenderzuar te sistemit te parkimit.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.4.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.2** *“Operatori Ekonomik duhet të paraqes Autorizim prodhuesi ose Distributori të autorizuar për zërat : 1) Pajisje për leshimin dhe matjen e kohës e parkimit, me ekran dhe aksesore; 2) Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore; 3) Pajisje bariere për kontrollin e levizjes së mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit); 4) Software qendror për menaxhimin e qenderzuar të sistemit të parkimit. Autorizimi i prodhuesit duhet të lëshohet në emër të autoriteti kontraktor dhe duhet të përmbajë të dhëna të plota si e-mail, numër kontakti, adrese, faqe web të prodhuesit, kjo në rast verifikimi nga autoriteti kontraktor.”*

III.4.2. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm*

*merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.4.3. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.4.4. Në nenin 40 pika 4 dhe 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore<sup>37</sup>, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

III.4.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specififikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikues dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikues dhe specififikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specififikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomikë ankimues se Operatori ekonomik i kualifikuar nuk plotëson kërkesat mbi kriteret e veçanta të kualifikimit sipas pikës 2.3.2, të kapaciteteve teknike, shtojca 8/2 e DT pasi nuk përmbanë të dhëna të plota dhe *ska paraqitur Autorizim prodhuesi ose Distributori të autorizuar për zërin Software qendror për menaxhimin e qendërve të sistemit të parkimit*. Komisioni i Prokurimit Publik edhe në këtë rast gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa e mësipërme i shërben synimit të autoritetit kontraktor dhe nuk shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. KPP konstaton, se kërkesa për paraqitjen e autorizim

prodhuesi, ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për zërat : 1) Pajisje për leshimin dhe matjen e kohës së parkimit, me ekran dhe aksesore; 2) Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore; 3) Pajisje bariere për kontrollin e levizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi i parkimit); 4) Software qendror për menaxhimin e qenderzuar të sistemit të parkimit, nuk është e egzagjeruar dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e synimit sepse si një artikull software në dallim nga ato fiziket nuk mund të gjendet aq lehtësisht në treg si pajisjet fizike nga furnitorë të zakonshëm dhe nga nuk mund të vërehet qartë plotësimi i specifikimeve teknike pa pasur në dispozicion autorizim prodhuesi, ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Në rastin konkret operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK ka paraqitur autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi por jo për zërat e kërkuara specifikisht në pikën 2.3.2 të DT, nga autoriteti kontraktor sic është dhe artikulli i software-it qendror për menaxhimin e qenderzuar të sistemit të parkimit .

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK tij me arsyen se: *“Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 8 e DT, Kemi dyshime që OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS, nuk ka plotësuar Vetedeklarimin sipas Formularit Permblidhes të Vetedeklarimit sipas shtojcës Nr. 9, të DST-ve, Seksioni B:DEKLARATE për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme . Nëse, po, numri i punonjësve Kemi dyshime që OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS, nuk ka paraqitur dokument që të provojë se ka se 5 ( pesë) punonjës (Vertetim për kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shendetesore për Tatimpaguesit E-SIG02/a) dhe nuk ka paraqitur as listepagese të muajit të fundit.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.4., “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2.3.3** *“Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar për muajin e fundit jo më pak se 5 ( pesë) punonjës në listë pagesë. Për këtë duhet të paraqesë listë pagesat e muajit të fundit.”*

III.5.2. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.3. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.5.4. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e fuqisë punetore prej 5 punonjeshish ne dispozicion ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin liste pagesat e muajit të fundit. KPP pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK vlerëson të plotësuar kriterin si në shtojcën 9 me ane të Formularit Permblidhes të Vetedeklarimit ashtu edhe në shtojcën 8 me listepagesat e dorëzuara për muajit 07/2024, 08/2024, 09/2025, 10/2024 respektivisht me nga 6 punonjesh sipas Deklaratës së “Listapagesave të kontirbuteve të sigurimeve shoqërore”.



KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është plotësuar nga operatori ekonomik INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK tij me arsyen se: *“Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.5, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 8 e DT, Kemi dyshime që OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS, nuk ka plotësuar Vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës Nr. 9, tE DST-ve, Seksioni B:DEKLARATE për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme . Kemi dyshime se OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS edhe mbas shpalljes fitues, nuk ka dorëzuar certifikate për të paktën një nga pajisjet e kuotuar , në rastin konkret , nga prodhuesi apo distributori i CAME .”* , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, pika 2.3.5., *“Kapaciteti teknik”* të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 inxhinierë elektronik ose informatike, të certifikuar në të paktën një nga pajisjet e kuotuar. Për këtë duhet të paraqesë liste pagesat e muajit të fundit, certifikatat e diplomat përkatëse.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nëni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.”*

Në nenin 82 *“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”* pika 1 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

III.6.2. Në nenin 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në

*vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.*

*7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”*

III.6.3. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.6.4. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.6.5. Në nenin 40 pika 4 dhe 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore<sup>37</sup>, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.”*

III.6.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

Në rastin konkret lidhur me pretendimin më sipër të operatorit ekonomik ankimues mbi kërkesën e autoriteti kontraktor për paraqitjen e minimalisht 1 inxhinierë elektronik ose informatike, të certifikuar në të paktën një nga pajisjet e kuotuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në secilen prej kërkesave të pikës 2.3.5, së pari, kërkesa mbart minimalisht 1 inxhinierë elektronik ose informatike KPP konstaton plotësimin e kësaj kërkesë me verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik perkateisht 2 diplomave, 1 inxhinieri

kompjuterik dhe 1 inxhinieri elektronik. Lidhur me kerkesen e certifikates ne te paktën një nga pajisjet e kuotuar te te diplomuarve konstatohet se referuar dokumentacionit eshte dorezuar certifikata e mbartur nga inxhinieri elektronik per gamen e produkteve te sistemeve te parkimit nga Came Parkare. Per sa i perket paraqitjes se liste pagesave te muajit te fundit, gjithashtu konstatohet dorezimi i tyre ne dokumnetacionin e paraqitur prej operatorit ekonomik ne autoritein kontraktor me punonjesit sipas diplomave dhe certifikatave perkatese te sipercituara. KPP gjykon, se operatori ekonomik "INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS" SHPK me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka ne liste pagesat e muajit te fundit inxhinierë elektronik dhe informatike, te certifikuar ne një nga pajisjet e kuotuar, sipas përcaktimit në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik. Gjithashtu operatori ekonomik ka plotesuar kete kriter edhe me shtojcen 9 te "Formularit permbledhes te vetedekalrimit", pika B: DEKLARATE per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme me fushat e numrit te punonjesve profilin dhe certifikimin.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "QuantX IT Solutions" SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Operatori ekonomik "INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS" SHPK tij me arsyen se: "*Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat mbi kapacitetin teknik sipas pikës 2.3.6, të kriterëve të veçanta për kualifikim, shtojca 8 e DT, Kemi dyshime qe OE INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS, nuk ka plotesuar Vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimt sipas shtojces Nr. 9, tE DST-ve, Seksioni B:DEKLARATE per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme . Profili i punonjesve Emer/Mbiemer te Punonjesve te certifikuar per ofrimin e suportit dhe mirembajtjes per sistemet e parkimit /Montues pajisje elektronike Certifikaten per ofrimin e suportit dhe mirembajtjes per sistemet e parkimit , ne kete rast nga prodhuesi CAME. Personat e paraqitur si Montues pajisje elektronike nuk jane sipas kodit perkates te profesionit ne listepagese*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", pika 2.3.6., "*Kapaciteti teknik*" të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*"2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka minimalisht per periudhen muajin e fundit punonjës të profilizuar si më poshtë:*

- *2 punonjes te certifikuar per ofrimin e suportit dhe mirembajtjes per sistemet e parkimit. Per kete duhet te paraqese certifikatat perkatese si dhe listepagesen e muajit te fundit.*

- 2 (dy) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike, kjo e vërtetuar me listpagesat e muajit të fundit sipas kodit perkates te profesionit.

-  
Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.7.2 Në nenin 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.”

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të



formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.7.3. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të

*përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.7.4. Në Nenin 92 pika 3 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”*

III.7.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që shërbimi/malli/puna e ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kriterëve kualifikuese dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i

shërbimeve/mallrave/punëve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret dhe specifikimet teknike të shërbimit të përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt prokurim.

III.7.6. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e 2 punonjes te certifikuar per ofrimin e suportit dhe mirembajtjes per sistemet e parkimit operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat perkatese si dhe listepagesen e muajit te fundit dhe per 2 (dy) punonjës të siguruar si montues të pajisjeve elektronike, duhet të paraqesin listpagesat e muajit të fundit sipas kodit perkates te profesionit. KPP gjykon se, në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar 2 punonjesve te certifikuar per ofrimin e suportit dhe mirembajtjes per sistemet e parkimit eshte plotesuar nga operatori ekonomik me dorezimin e 2 certifikatave respektive “Mbeshtetja dhe mirembajtja e produkteve te sistemeve te parkimit te CAME PARKARE” te punonjesve te cliet rezultojne edhe ne listpagesat e 4 muajve te fundit te dorezuara nga operatori ekonomik. Lidhur me vërtetimin e 2 (dy) punonjësve të siguruar si montues të pajisjeve elektronike, me listpagesat e muajit të fundit sipas kodit perkates te profesionit, KPP-ja konstaton se jane paraqitur certifikatat e 2 punonjesve si ”Montues i pajisjeve te sistemit te parkimit CAME PARKARE” por keta te certifikuar nuk rezultojne ne listpagesat sipas kodit perkates te profesionit te montues të pajisjeve elektronike 8213.

Duke iu kthyer plotesimit te kriterit apo ajo, KPP konstaton, se kriteri eshte plotesuar pjeserisht sipas përcaktimit në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Tetra” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-26387-10-25-

2024, me objekt “Smart Parking ne Kalane e Beratit”, me fond limit 5,265,500.00 (pesë milion e dyqind e gjashtedhjet e pesë mijë e pesëqind) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” Shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-26387-10-25-2024, me objekt “Smart Parking ne Kalane e Beratit”, me fond limit 5,265,500.00 (pesë milion e dyqind e gjashtedhjet e pesë mijë e pesëqind) Lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 11.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Berat.

3. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SHPK duke e skualifikuar sipas konstatimeve të vendimit të Komisionin e Prokurimit Publik.

4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” Shpk.

6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Terta” Shpk, në buxhetin e shtetit.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

